



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE

Nr. 2, datë 22.02.2018

**PËR FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE DHE MBIKËQYRJES SË PROCESIT TË TESTIMIT TË
KANDIDATËVE PËR AUDITUES LIGJOR DHE KONTABILIST TË MIRATUAR**

TË

BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

*Ndryshuar me Vendimin nr. 69, datë 16.10.2020 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike
Ndryshuar me Vendimin nr. 9, datë 21.03.2024 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike*

Kjo rregullore është hartuar në bazë të:

Nenit 5 pika 1, a, b, h, Nenit 15, Nenit 16, Nenit 17, Nenit 18, Nenit 49, Nenit 50 dhe Nenit 51 të Ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi dhe objekti i kësaj rregullore**

1. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së funksionimit të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe mënyrës së mbikëqyrjes së procesit të testimit dhe vlerësimit të kandidatëve për AL dhe KM.
2. Kjo rregullore parashikon edhe rregullat dhe kriteret e përgjithshme mbi bazën e të cilave përgatiten të gjitha, aktet, rregullat dhe vendimet që dalin në zbatim të kësaj rregullore nga BMP, KPAP si dhe organizatat profesionale të parashikuara në dispozitat e kësaj rregullore.
3. Në këtë rregullore parashikohen gjithashtu rregullat e përgjithshme për mbikëqyrjen dhe rregullimin e procesit të testimit dhe certifikimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Neni 2
Shkurtime dhe Përkufizime

1. Shkurtime të përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

KPAP – Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

BMP – Bordi i Mbikëqyrjes Publike

SM – Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

PTAP – Provimet Teorike të Aftësive Profesionale

PPAP – Provimet Përfundimtare të Aftësive Profesionale

KM – Kontabilist i Miratuar

AL – Auditues Ligjor

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

Institucion: Me termin institucion për qëllime të këtij ligji do të nënkuptohen organizatat profesionale (të audituesve ligjorë apo kontabilistëve të miratuar).

Person përgjegjës për mbikëqyrjen (PPM) – Është personi përgjegjës, i caktuar në përputhje me aktet rregullatore të miratuar nga BMP, i cili kryen funksionet e parashikuara në këtë rregullore.

Provim për zhvillimin profesional: Është provimi vullnetar që japin KM për qëllim të njehsimit të kurrikulave me programet e reja të aprovuara për qëllime të ndryshme akademike apo për të vazhduar programin për KM.

Provim përfundimtar: Për qëllime të kësaj rregullore termi “provim përfundimtar dhe “provime përfundimtare” janë sinonime të njëra tjetrës dhe nënkuptojnë PPAP.

Format i përgjithshëm i tezës: Është formati i përgjithshëm i tezave të PPAP në të cilin jepet informacion mbi numrin dhe formatin e pyetjeve dhe ushtrimeve dhe kategorizimin sipas seksioneve. Në formatin e përgjithshëm jepet informacion edhe mbi numrin e pikëve të aplikuar për secilën pyetje dhe seksion. Formatin e përgjithshëm i tezës nuk përmban pyetje apo ushtrime konkrete por një përshkrim të përgjithshëm të natyrës së ushtrimit apo pyetjeve dhe referimit me kurrikulat përkatëse.

BSNEK - Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

IFIAR – “The International Forum of Independent Audit Regulators” – Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Kontrollit;

ACCA – “The Association of Chartered Certified Accountants” – Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Autorizuar;

IFAC – “International Federation of Accountants” – Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve;

OPAL – Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë

OPKM – Organizata Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar

Specializim të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën: Me specializim për qëllime të kësaj rregulloreje do të përfshihen si më poshtë (të paktën njëra prej tyre):

- a) Certifikim/Titull profesional brenda ose jashtë vendit në fushat e mësipërme;
- b) Diplomë në fushat e mësipërme;
- c) Master në fushat e mësipërme;
- d) Kurs profesional që zotëron të paktën 20 kredite në fushat e mësipërme, të njohura ndërkombëtarisht ose nga institucioni vendor përkatës;
- e) Eksperiencë profesionale prej së paku 5 vite të lidhura me fushat e mësipërme.

Faqe Elektronike e BMP-së: Për qëllime të kësaj rregulloreje me faqe elektronike do të nënkuptohet njëra ose të gjitha nga të mëposhtmet (kur është e mundur):

- a) Llogaria/faqe zyrtare;
- b) Mediat sociale në facebook; twitter;
- c) Adresat elektronike.

Ligji për auditimin: Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.

2. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.
3. Termat ose shkurtime të më sipër mund të përdoren si zëvendësues të njëra-tjetrës.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI i KPAP-së

Neni 3
Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

1. Për të realizuar testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjorë, pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) ngrihet dhe funksionon Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

2. KPAP përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga BMP për një periudhë katër vjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:
 - a) kryetari nga Ministri i Financave;
 - b) dy anëtarë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
 - c) një anëtar nga organizmat profesionalë apo Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
 - ç) një anëtar nga profesorati i fushës së universiteteve.

3. Përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, duhet të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushat e ekonomisë dhe/ose të jurisprudencës, të cilat duhet të jenë të lidhura me auditimin, kontabilitetin dhe financën, me përvojë profesionale jo më të vogël se dhjetë vite, ose 7 vite përvojë pune, në rast se mbajnë një grade apo titull shkencor. Gjithashtu, përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2 të këtij neni duhet të:
 - a) jenë shtetas shqiptarë;
 - b) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
 - c) të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo strukturat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komisionit;
 - ç) të mos jenë të angazhuar në role apo funksione politike;
 - d) të mos jenë në strukturat/këshillat drejtuese të më shumë se një nga organet/institucionet/organizatat e parashikuara në ligjin 10091/2009 që lidhen drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë me përzgjedhjen dhe veprimtarinë e KPAP.

4. Përveç kriterëve të mësipërme për përfaqësuesit e parashikuar në pikën 2 të këtij neni do të konsiderohen preferenciale kriteret e mëposhtme:
 - a) të kenë eksperiencë në ligjërime apo trajnime profesionale në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe financës;
 - b) të kenë publikime në revista shkencore, konferenca ose pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore së paku në 5 vitet e fundit në fushën e auditimit, kontabiliteti dhe financës.

5. Për përfaqësuesit e parashikuar në germat b, c, të pikës 2 të këtij neni që përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3, kandidatët aplikojnë pranë institucioneve përkatëse, sipas rregulloreve të brendshme të funksionimit, të miratuara në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Propozimet, nga këto institucione, së bashku me dokumentacionin e kandidatëve dorëzohen pranë Strukturës Mbështetëse të BMP-së sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe kuadrit rregullator të miratuar nga BMP-ja. Këto institucione duhet të përfshijnë në listën e propozimeve të kandidatëve që plotësojnë kriteret, si dhe listën e plotë të të gjithë kandidatëve që kanë konkurruar.

6. Përfaqësuesit e parashikuar në germën ç) aplikojnë drejtpërdrejtë pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

7. Kandidatët për anëtarë që i propozohen BMP-së nga institucionet, duhet të përzgjidhen prej tyre në një proces të hapur, transparent, gjithëpërfshirës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Dokumentacioni i përzgjedhjes ruhet pranë organizatës profesionale për të paktën tre vite, dhe është subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.
8. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përzgjedh anëtarët, nga radhët e kandidatëve, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe dispozitat e statutit të BMP-së duke konsideruar kriteret dhe përfaqësimin e profesionit kontabël.
9. Në rastin e pikës 2 germa b) dhe c) institucionet njoftohen me shkresë e cila publikohet edhe në faqen elektronike të BMP-së. Në rastin e germës ç) njoftimi bëhet përmes njoftimit ose publikimit në faqen elektronike të BMP-së. Për përfaqësuesin e parashikuar në germën a) të pikës 2 të këtij neni, BMP njofton me shkresë Ministrin përgjegjës për Financat.
10. Në rast se nuk janë respektuar kërkesat e kësaj rregulloreje BMP-ja ka të drejtën të aplikojë masa ndëshkimore ndaj institucioneve propozuese dhe personave përgjegjës, subjekt i mbikëqyrjes nga BMP, të cilët nuk kanë respektuar këto kërkesa në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në rast se evidentohen shkelje të kërkesave të kësaj rregulloreje BMP-ja ka të drejtën të i përjashtojë këto institucione nga e drejta e propozimit për një periudhë deri në 5 vite duke lejuar aplikim të lirë të kandidatëve të këtyre institucioneve përmes një procedure të veçantë, e cila miratohet nga BMP-ja.
11. Përmes një procesi vlerësimi të dosjes së kandidatëve për t'u përzgjedhur si anëtarë të KPAP-së, BMP përzgjedh dhe emëron kandidatët fitues të propozuar nga institucionet e përcaktuara në gerrat c) e ç) të pikës 2 me shumicë të thjeshtë të anëtarëve pjesëmarrës. Procesi i vlerësimit bëhet nga një komision "Ad-Hoc" nga struktura mbështetëse që bën vlerësimin e aplikimeve dhe ia paraqet BMP-së për vendimmarrje. Sistemi i vlerësimit miratohet me vendim të veçantë nga BMP-ja në momentin e shpalljes së vendeve vakante duke konsideruar kriteret e përcaktuara në këtë nen.
12. BMP mund të lirojë nga detyra anëtarët e KPAP-së nëse:
 - a) anëtari nuk paraqitet në mbledhje tre herë radhazi apo më shumë se shtatë mbledhje përgjatë vitit;
 - b) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KPAP-së, BMP-së dhe profesionit të AL dhe KM;
 - c) janë shkelur procedurat e propozimit të parashikuar në këtë rregullore;
 - ç) kryen veprime të paligjshme apo që cenojnë rëndë imazhin e KPAP-së dhe BMP-së;
 - d) kur ka marrë më shumë se tre vërejte me shkrim nga kryetari i BMP-së për shkelje apo sjellje të papajtueshme me kuadrin rregullator në fuqi (në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje);
 - dh) kur nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;
 - e) përfshihet në veprime të dhunshme duke ushtruar forcë fizike;
 - ë) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- f) ka konflikt interesi me funksionin e vet;
- g) dorëhiqet apo vdes;
- g) kur nuk është më anëtarë ushtrues (aktiv) i organizatës profesionale apo nuk përfaqëson më institucionin që e ka propozuar;
- gj) në rast të shkeljeve etike pranë institucioneve ku ka aderuar më parë apo edhe shkeljeve etike gjatë angazhimit pranë BMP-së, në përputhje me kërkesat përkatëse në kodin e etikës së BMP dhe atij të IFAC ;
- h) në rast mosdhënie informacioni apo mosdorëzime të dokumentacionit brenda afateve të parashikuara në këtë rregullore apo kur kërkohen nga Kryetari apo drejtori ekzekutiv i BMP-së.

Në rastin e lirimit të anëtarit të KPAP, sipas përcaktimeve të pikës 12, Bordi duhet të emërojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e marrjes së propozimit/aplikimit përkatës, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes, të parashikuara në këtë nen. Në rastin e anëtarëve të ardhur sipas pikës 2 germa b), c) ç) BMP nga lista e aplikimit/propozimit të ardhur zgjedh edhe anëtarët zëvendësues të cilët ushtrojnë kompetencat e anëtarit të liruar/pezulluar deri në përzgjedhjen e anëtarit të ri ose ndërprerjes së procesit të pezullimit.

13. Bordi i Mbiqyrjes Publike mund të bëjë pezullimin e menjëhershëm të secilit prej anëtarëve në rastet kur ndaj tyre:
- a) konstatohet shkelje e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi;
 - b) ka nisur proces investigimi lidhur me veprimtarinë e tij që lidhet me ushtrimin e detyrës si anëtar i KPAP-së, të cilat cenojnë imazhin e KPAP-së dhe BMP-së;
 - c) përfshihet në konflikte të cilat përfshijnë dhunën fizike apo presionin verbal që vë në kërcënim jetën, pasurinë, punën apo karrierën e cilitdo personi, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së funksioneve të veta si anëtar i KPAP-së ose që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë si anëtar i KPAP-së;
 - ç) në rast se anëtari është ushtrues i profesionit apo ka qenë më parë ushtrues i profesionit dhe nga procesi i Kontrollit të Cilësisë janë evidentuar gjetje të cilat në përputhje me vendimin 39/2019 e kategorizojnë me notën D ose F, ose në rastet kur Komisioni i Investigimit ka rekomanduar masa disiplinore administrative;
 - d) në rast të indicieve për shkelje etike pranë institucioneve ku ka aderuar më parë apo edhe shkeljeve etike gjatë angazhimit pranë BMP-së, në përputhje me kërkesat përkatëse në kodin e etikës së BMP dhe atij të IFAC;
 - e) për çdo rast tjetër që parashikohet nga kuadri rregullator në fuqi.
14. Nga momenti pezullimit, anëtarit të pezulluar i njoftohet vendimi dhe i kërkohet informacion dhe evidencë mbështetëse për të verifikuar kushtet e papajtueshmërisë. Në rast se anëtari i pezulluar nuk depoziton informacionin dhe evidencat e kërkuara brenda 10 ditësh kalendarike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

atëherë bëhet shkarkimi/lirimi i tij. Në rast se nga verifikimi i këtyre evidencave konstatohet se ka shkelje atëherë anëtari shkarkohet.

Në rast të shkarkimit të anëtarit sipas rasteve të parashikuara në pikën 12 dhe 14 të këtij neni zgjedhja e anëtarit të ri bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 4

Kompetencat mbi organizimin dhe realizimin e procesit të provimeve

1. KPAP merret me zbatimin e procedurave të testimit, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale të kandidatëve që kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenet 15, 16, 18, 49 dhe 50 të ligjit për auditimin, sipas ndarjes më poshtë:
 - 1.1 Kandidati për kontabilist i miratuar duhet të plotësojë kërkesat në vijim:
 - a) të ketë zotësi për të vepruar;
 - b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
 - b/1) të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria dhe/ose në gjykim për vepra penale;
 - c) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;
 - ç) ka, të paktën, tre vite përvojë profesionale në fushën e kontabilitetit, të financës, kontrollit financiar dhe në fusha të ngjashme;
 - d) ka kryer kursin e kualifikimit në fushën e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar, të organizuar ose të monitoruar nga organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar, e njohur nga BMP-ja, në të cilën individi dëshiron të anëtarësohet, si dhe testimet përkatëse sipas kuadrit rregullator në fuqi.
 - 1.2 Kandidati për auditues ligjor, me përjashtim të rasteve kur në ligjin për auditimin ose në këtë rregullore ose rregulloret dhe vendimet e tjera të miratuara nga BMP -ja, në përputhje me ligjin e auditimit parashikohet ndryshe, duhet të plotësojë kërkesat në vijim:
 - a) të ketë zotësi për të vepruar;
 - b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
 - b/1) të mos jenë në ndjekje penale nga prokuroria dhe/ose në gjykim për vepra penale;
 - c) të ketë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë në nivelin “Master”, ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar ose ekuivalente me këtë nivel për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- ç) të ketë kaluar me sukses të gjitha testet e parashikuara në programin e përgatitjes teorike profesionale në përputhje me rregullat dhe procedurat e testimit, të propozuara nga organizata profesionale dhe të miratuara nga Bordi;
- d) të ketë kryer gjysmën e praktikës profesionale, e cila zgjat në total 3 vite, në kushtet e punësimit me kohë të plotë në auditimin e pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara ose pasqyrave financiare të tjera, të ngjashme, pranë një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi të njohur në Republikën e Shqipërisë, që dallohet për reputacion të mirë dhe nën udhëheqjen e audituesve ligjorë që kanë garancitë e mjaftueshme për këtë qëllim. Të paktën dy të tretat e kësaj praktike profesionale duhet të kryhen pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie auditimi, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. Rregullat, procedurat e testimit, sistemi i vlerësimit, formati i përgjithshëm i tezës (për PPAP), koha e provimit, për çdo disiplinë të parashikuar në nenin 18 të ligjit për auditimin, propozohen nga organizata e audituesve ligjorë, dhe miratohen nga BMP, në përputhje me kriteret dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore duke mbajtur në konsideratë dhe pa rënë ndesh me rregulloret dhe vendimet e tjera të miratuara nga BMP-ja.
3. Programet e disiplinave të parashikuara në nenin 18 të ligjit, për PPAP, për provimet për titullin e Audituesit Ligjor dhe për provimet për titullin Kontabilist i Miratuar, propozohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, pasi ka shqyrtuar paraprakisht opinionin në formë të shkruar nga organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohur nga BMP. Propozimet e konsoliduara, të shoqëruara me relacionin përkatës, dorëzohen pranë BMP-së për t'u miratuar. Programet e disiplinave pasi të miratohen nga BMP, duhet të publikohen të paktën 3 muaj përpara caktimit të datave të provimeve.
4. Propozimet e ardhura nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, BMP-ja në përputhje me këtë rregullore, mund t'i miratojë, t'i kthejë për rishqyrtim me sugjerime dhe komente të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar, ose t'i rishqyrtojë vetë duke bërë ndryshimet në rast se janë të nevojshme e më pas t'i miratojë.
5. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar kryhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, nën mbikëqyrjen e Bordit të Mbikëqyrjes Publike sipas përcaktimeve dhe kërkesave të kësaj rregullore. Sekretaria teknike për organizimin e provimit përfundimtar ka vetëm kompetenca teknike të cilat janë të përcaktuara në dispozitat e kësaj rregulloreje, e cila mund të asistohet edhe nga Struktura Mbështetëse. Personat që angazhohen në sekretarinë teknike përzgjidhen nga këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, të cilët mund të jenë ose jo pjesë e strukturës së përhershme administrative të saj.
6. Organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të sigurojë që ekipi i përfshirë në përgatitjen e propozimit për përgatitjen e rregullave dhe procedurave të testimit duhet të ketë nivelin e duhur profesional dhe akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

7. Për të garantuar mbarëvajtjen e procesit të testimit KPAP fillon procesin e përzgjedhjes së hartuesve dhe hartues rishikues jo më vonë se 3 muaj përpara datës së testimit. Hartuesit depozitojnë fondin e pyetjeve pranë KPAP-së të paktën 15 ditë përpara datës së provimit. Pyetjet përfshijnë një kombinim të pyetjeve me alternativa, pyetjeve të zhvillimit teorik dhe pyetjeve të tipit rast studimor. Dorëzimi i fondit të pyetjeve do të bëhet në zarf të mbyllur, në CD/USB të mbyllur e të nënshkruar në prani të KPAP. KPAP përgatit testet e mundshme për provimin final nga fondi i pyetjeve të hartuesve në jo më pak se 3 versione të cilat i dorëzohen rishikuesit/ve të tezës, jo më herët se pesë ditë para datës së provimit. Rishikuesi i cilësisë së tezës përgatit versionet e tij pranë ambienteve të BMP ose ambienteve të autorizuara nga BMP me vendim të veçantë me qëllim që të sigurohet integriteti i procesit. Rishikuesi i cilësisë së tezës bën vlerësimin e përmbajtjes së çdo pyetje të përfshirë në tezë, vlerëson kohën e nevojshme për të zgjidhur secilën nga këto teza dhe modifikon jo më pak se 15% dhe jo shumë se 30% të pyetjeve/ushtrimeve të tezës. Këto ndryshime duhet të kenë karakter cilësor dhe ta bëjnë tezën më të plotë dhe më përfshirëse në raport me programin. Gjithashtu, rishikuesi i cilësisë së tezës mund të modifikojë pjesërisht pyetjet dhe ushtrimet për të gjithë tezën pa prekur përmbajtjen kryesore dhe strukturën me qëllim garantimin e konfidencialitetit dhe cilësisë. Të gjitha versionet e tezave i dorëzohen KPAP jo më herët se 4 orë nga nisja e provimit përfundimtar në një zarf, në CD/USB të mbyllur e të nënshkruar në prani të KPAP.
- 7.1 Pyetjet e hartuara dhe të përzgjedhura për përdorim në provim, të cilat janë vlerësuar nga hartuesi rishikues si të vlefshme për përdorim të mëvonshëm me aprovim të KPAP ose Komisionit të Rishikimit do të transferohen në fondin e pyetjeve në formën e fondit shtesë të pyetjeve për t'u konsideruar si bazë për t'u përdorur në sezonet e mëpasshme me kushtin që mos të ketë element përsëritës me tezat e kryera në periudhat e mëparshme. Për fondin e pyetjeve për përdorim të mëpasshme do të zbatohen të njëjtat masa mbi sigurinë dhe ruajtjen e përmbajtjes, si për pyetjet pjesë të fondit të pyetjeve të PPAP.
8. KPAP-ja miraton vlerësimin përfundimtar të kandidatëve dhe bën publikimin e rezultateve në përputhje me këtë rregullore.
9. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen ndjek të gjithë procesin e organizimit të testimit, procesin e korrigjimit dhe vlerësimit duke qenë i pranishëm në të gjitha proceset që marrin pjesë dhe përfshihen anëtarët e KPAP-së dhe sekretaria teknike.

Neni 4/1

Rishikimi i Cilësisë së procesit të provimit të aftësive profesionale

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike për të mundësuar një proces cilësor në hartimin, korrigjimin, dhe rishikimin ngre pranë tij komisionin për rishikimin e cilësisë së procesit të testeve me mandat 4 vjeçar.
2. Komisioni i rishikimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë profesionistë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- a. 2 (dy) ndër të cilët të jenë juristë, të cilët duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:
 - të jetë shtetas shqiptar;
 - të zotërojë Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to si dhe titullin, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - të ketë mbi 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - të ketë njohuri të mira të legjislacionit të lidhur me fushën dhe kuadrit rregullator të BMP-së;
 - të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij.
- b. 3 (tre) prej anëtarëve do të përzgjidhen nga profesionistë të fushës së kontabilitetit, auditimit, fiskale, e të menaxhimit që plotësojnë kërkesat si më poshtë:
 - të jetë shtetas shqiptar;
 - të zotërojë Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to si dhe titullin, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - të ketë mbi 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - të ketë njohuri të mira të legjislacionit të lidhur me fushën dhe kuadrit rregullator të BMP-së;
 - të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij.
3. Komisioni i Rishikimit, ka kompetencat si më poshtë:
 - të verifikojë hartuesit dhe korigjuesit që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore;
 - të verifikojë rishikuesit e cilësisë së hartimit të tezës që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore që do të kontrollojnë cilësinë e fondit të pyetjeve të përgatitura nga hartuesit;
 - të verifikojë ri korigjuesit që propozohen nga KPAP në përputhje me këtë rregullore që do të angazhohen për të rishikuar rastet e fletoreve të korigjuara për të gjitha diferencat mbi 5% të pikëve, që rrjedhin nga procesi i korigjimit të dy grupeve paralele të korigjuesve.
4. Shkarkimi i anëtarit të komisionit të rishikimit bëhet sipas të njëjtave dispozita që aplikohen për shkarkimin/lirimin e anëtarit të KPAP.

Neni 5
Kandidatët për hartues dhe korigjues

1. KPAP përzgjedh dhe përcakton numrin e nevojshëm të hartuesve, rishikuesve dhe korigjuesve dhe ri korigjuesve. Përzgjedhja bëhet në përputhje me kërkesat e kësaj rregullore.
2. Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit, hartuesit rishikues dhe korigjuesit dhe ri korigjuesit janë si më poshtë:
 - a) Hartuesit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me kurrikulën në të cilën do të angazhohen:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
 - ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - iii. Si dhe përveç pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.
- b) Hartuesit rishikues duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në përputhje me kurrikulën në të cilën do të angazhohen:
- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
 - ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
 - iii. Si dhe përveç pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.
- c) Korrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
 - iii. Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse ;
- d) Ri korrigjuesit duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:
- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
 - ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- dh) Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;
3. Anëtarët e KPAP-së përjashtohen nga e drejta për të qenë hartues, rishikues, korrigjues apo ri korrigjues.
 4. Çdo kandidat që aplikon për hartues, hartues rishikues, korrigjues dhe ri korrigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:
 - a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
 - b. Curriculum Vitae;
 - c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
 - d. Fotokopje të diplomave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- e. Shfuqizohet
 - f. Certifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).
5. KPAP, në përfundim të procedurave të përzgjedhjes, pas verifikimit nga Komisioni i Rishikimit, miraton listën e hartuesve, hartuesit/ve rishikues dhe korrigjuesit dhe ri korrigjuesit që plotësojnë kriteret, në përputhje me pikën 2 të këtij neni të kësaj rregulloreje.
 6. Komisioni Rishikimit, përveçse bën verifikimet për të gjithë kandidatët për hartues, hartuesit rishikues dhe korrigjuesit dhe ri korrigjuesit në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, për të garantuar një përzgjedhje sa më cilësore dhe në rast se konstaton parregullsi ose papajtueshmëri apo në rast se kandidatët nuk plotësojnë kriteret, bën skualifikimin e tyre duke kërkuar propozime shtesë.
 7. Përzgjedhja e hartuesve, hartuesve rishikues, korrigjuesve dhe ri korrigjuesve duhet të garantojë objektivitetin e procesit duke nënvizuar shmangien e konfliktit të interesit midis tyre dhe mos përfshirjen në më shumë se një proces në të njëjtin provim.
 8. Të gjithë hartuesit, hartuesit rishikues, korrigjues dhe ri korrigjuesit e provimeve përfundimtare mund t'i nënshtrohen trajnimit. Programin e trajnimit dhe trajnimin e organizon KPAP nën mbikëqyrjen e BMP.

Neni 6

Mbledhja dhe pagesat e anëtarëve të KPAP-së

1. KPAP do të mbledhet së paku 12 herë në vit.
2. KPAP përgatit një plan vjetor pune ku specifikohen edhe mbledhjet e planifikuara përgjatë vitit, të cilin ia kalon për miratim BMP-së në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje.
3. Mbledhja e KPAP-së mund të bëhet edhe jashtë planit vjetor në raste të jashtëzakonshme me kushtin që ato të aprovohen nga BMP-ja.
4. Me propozim të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, njëri nga anëtarët e propozuar sipas pikës 2 (b) të nenit 3 përzgjidhet nënkryetar.
5. Mbledhja e KPAP-së thirret dhe drejtohet nga Kryetari, jo më herët se 24 orë para saj. Në mungesë të kryetarit dhe me autorizim të tij, mbledhjet mund të drejtohen nga nënkryetari, të cilit i delegohen nga kryetari të drejtat e tij të parashikuara në këtë rregullore. Mbledhjet e KPAP mund të thirren dhe jashtë Planit Vjetor të Punës me kërkesë të BMP-së.
6. Mbledhjet e KPAP-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se katër anëtarë. Nëse njëri nga anëtarët mungon në tre mbledhje radhazi, të paarsyetuara (përjashtimisht rastet e shërbimeve jashtë shtetit dhe sëmundjet) propozohet zëvendësimi i tij brenda sezonit. Për ditët e mungesave me dhe pa arsye nuk kryhet pagesë. Vendimet janë të vlefshme, kur votojnë “pro”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

shumica e anëtarëve pjesëmarrës. Në rast të numrit të barabartë të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit të KPAP-së konsiderohet përcaktuese. Vendimet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës. Ato duhet të jenë të argumentuara dhe në çdo rast, votat “kundër” duhet të shpjegohen në procesverbalin e mbledhjes. Në raste emergjence apo të kushtëzuara nga rrethana objektive KPAP mund të marrë edhe vendime qarkulluese.

7. Vendimet e KPAP-së përgatiten në tre kopje, të cilat dy kopje mbahen në sekretarinë teknike të KPAP-së dhe një kopje pranë Strukturës Mbështetëse të BMP-së. Sekretaria teknike e KPAP-së që angazhohet pranë BMP mban protokoll të posaçëm për veprimtarinë në lidhje me KPAP-në.
8. Mbledhja e Komisionit konsiderohet e vlefshme kur ka rend dite të përcaktuar, të hartuar nga Kryetari, e cila procedon me vendimmarrje për të gjitha çështjet e parashikuara në rendin e ditës. Me miratimin e datave të testeve në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, KPAP nuk mund të shqyrtojë dhe të marrë vendime në lidhje me pezullimin/anulimin e realizimit të procesit të testeve, me përjashtim të rasteve kur me ligj ose akt normativ për shkak të situatës së jashtëzakonshme parashikohet ndryshe. Në çdo rast një vendim i tillë miratohet nga BMP. BMP mund të kërkojë përfshirjen në rend dite të KPAP-së edhe çështje të cilat mund të konsiderohen të nevojshme të shqyrtohen nga KPAP.
9. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje u shpërndahen paraprakisht anëtarëve nga sekretaria teknike. Të gjitha materialet i dorëzohen njëkohësisht edhe personit përgjegjës për mbikëqyrjen.
10. KPAP-ja i zhvillon mbledhjet pranë ambienteve të BMP-së ose ambienteve të autorizuara nga BMP-ja me vendim të veçantë me kushtin që të sigurohet integriteti i procesit.
11. Miratimi i pagesave për anëtarët e KPAP-së, të propozuara nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale, do të bëhet me vendim të veçantë, të miratuar nga BMP për referencat e pagave të komisionit të KPAP-së dhe buxhetit të funksionimit të KPAP-së. Pavarësisht volumit të punës apo mënyrës së shpërndarjes së kohës, anëtarët e KPAP-së do të paguhet jo më shumë se 40 mbledhje përgjatë një sezoni të plotë provimesh.

Neni 7
Buxheti dhe tarifat e regjistrimit

1. Kostot e administrimit të veprimtarisë së KPAP-së mbulohen nga tarifat e regjistrimit të kandidatëve që testohen në përputhje me rregulloren për mbledhjen e të ardhurave të miratuar nga BMP-ja. Tarifat e regjistrimit të arkëtuara janë të pakthyeshme. Kandidatëve që kanë kryer pagesat dhe për arsye të ndryshme nuk janë paraqitur në testim, pagesa i njihet vetëm për sezonin e menjëhershëm pasardhës.
2. Personat që angazhohen si vëzhgues, hartues, hartues rishikues, korrigjues, korrigjues rishikues, në procesin e rishikimit, si dhe personeli tjetër ndihmës marrin honorare, masa e të cilave miratohet nga BMP-ja në përputhje me procedurat e pikës 3 të këtij neni.
3. Sekretaria teknike e KPAP-së përgatit një preventiv lidhur me shpenzimet e nevojshme për procesin e organizimit dhe realizimit të provimeve. Mbi bazën e të dhënave të siguruara dhe me



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

propozim të strukturës përgjegjëse për financën, BMP-ja shqyrton dhe miraton këtë preventiv shpenzimesh në përputhje me referencat maksimale miratuar prej tij, për çdo sezon, 10 ditë pas shpalljes së listës së aplikantëve nga KPAP, por jo më vonë se 2 javë përpara provimit të parë. Pas miratimit të këtij preventivi nga BMP,-ja ngarkohet struktura përgjegjëse për financën të ndjekë zbatimin e tij. Në varësi të numrit të kandidatëve të regjistruar dhe me kërkesë të Strukturës së BMP-së, Bordi mund të rishikojë preventivin e miratuar.

4. Struktura përgjegjëse për financën pranë BMP-së mban regjistrime të veçanta të arkëtimit dhe pagesave që lidhen me veprimtarinë e KPAP-së. Në përfundim të procesit të testimit të kandidatëve, SM i paraqet BMP-së një raport financiar ku evidentohen arkëtimet, shpenzimet e kryera për testimin e kandidatëve dhe teprricat e mbetur ose diferencat e pambuluar.
5. Shpenzimet e lidhura me procesin e provimeve sipas preventivit të miratuar nga BMP, kryhen në përputhje me rregulloren për të ardhurat miratuar nga BMP.

KREU III
MBIKËQYRJA E FUNKSIONIMIT TË KPAP-së DHE PROCESIT TË CERTIFIKIMIT

Neni 8
Mbikëqyrja e funksionimit të KPAP-së

1. Për të realizuar procesin e mbikëqyrjes të funksionimit dhe organizimit të KPAP-së si dhe procesit të organizimit të provimit përfundimtar BMP-ja cakton një person përgjegjës për mbikëqyrjen (PPM) pranë KPAP-së i cili do të mbikëqyrë procesin e organizimit të provimeve përfundimtare të aftësive profesionale të kandidatëve për AL dhe KM.
2. Sekretaria e Teknikës e KPAP-së do të mbikëqyrë nga PPM për çdo informacion apo dokumentacion, apo dosje të dorëzuar pranë KPAP-së apo të ardhur pranë saj, lidhur me të gjithë procesin e organizimit të testimit. PPM-ja është i detyruar të raportojë pranë BMP-së në lidhje me veprimtarinë e KPAP-së, nëpërmjet një raporti përmbledhës.
3. PPM-ja merr pjesë në çdo mbledhje të KPAP-së.
4. Në rast se përgjatë procesit të mbledhjes së anëtarëve të KPAP-së vëren se ka çështje të cilat bien ndesh me këtë rregullore apo me ligjin apo me çdo vendim të nxjerrë nga BMP-ja, përmes një raporti PPM-ja informon brenda 5 ditëve pune anëtarët e BMP-së. BMP-ja mblidhet brenda jo më pak se 5 ditëve pune për të shqyrtuar problematikën në fjalë. Vendimi i marrë nga BMP-ja konsiderohet përfundimtar. Ky vendim iu vihet në dijeni anëtarëve të KPAP-së dhe bëhet i zbatueshëm menjëherë nga momenti i marrjes së tij.
5. PPM-ja përgjatë kryerjes së funksioneve të përcaktuara në këtë rregullore mbështetet nga Struktura Mbështetëse në logjistikë apo burime njerëzore, nëse kërkohet.
6. BMP-ja mund të kërkojë pavlefshmërinë e çdo vendimi të marrë nga KPAP-ja në rastet kur gjykon se vendimi bie ndesh me këtë rregullore, çdo rregullore tjetër apo vendim të dalë prej BMP-së apo bie ndesh me ligjin për auditimin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

7. Pagesa e personit përgjegjës për mbikëqyrjen do të bëhet në përputhje me rregulloren e funksionimit të strukturës mbështetëse. Emërimi bëhet në përputhje me dispozitat statutorë të BMP-së. Në rregulloren e funksionimit të strukturës mbështetëse përveç detyrave të parashikuara në këtë rregullore për PPM-në mund të përcaktohen edhe detyra të tjera shtesë.
8. Për të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë nen PPM-ja ndjek zbatimin e kësaj rregulloreje dhe informon BMP-në përmes një raporti të hollësishëm mbi problematikat dhe zbatimin e saj.
9. Në raste të jashtëzakonshme të cilat lidhen me ngjarje që cenojnë rëndë reputacionin e KPAP-së, BMP-së apo imazhin e profesionit, BMP e cila mund të jetë vënë në dijeni nga personi përgjegjës për mbikëqyrjen apo nga burime të tjera alternative dhe mund të kërkojë pezullimin e procesit dhe shqyrtimin e çështjes në BMP. Anëtarët e BMP-së në rastin e vënies në dijeni nga burime alternative vënë menjëherë në dijeni Kryetarin i cili duhet të bëjë thirrjen e BMP-së në përputhje me kërkesat statutorë të BMP-së.
10. Përveç PPM-së si dhe strukturës mbështetëse, çdo anëtar i BMP-së mund të jetë prezent për të vëzhguar procesin e kryerjes së provimeve.

Neni 9
Provimi i Aftësive Profesionale

1. Për të kryer testimet, në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale (PPAP), kandidatët duhet t'i drejtojnë kërkesë me shkrim së bashku me dokumentacionin mbështetës Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP). Kërkesa depozitohet në dy kopje. Originali së bashku me dokumentacionin mbështetës pranë sekretariatit teknik të KPAP-së ndërsa një kopje e kërkesës, së bashku me mandatin e bankës (që dëshmon pagesën e aplikimit për regjistrim) pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike, të cilat depozitohen pranë Strukturës Mbështetëse të BMP-së. Kërkesa duhet të përmbajë informacion mbi të gjithë listën e dokumenteve të dorëzuara në dokumentacionin e aplikimit që tregojnë përmbushjen ose jo të kërkesave ligjore të renditura në nenin 4 të kësaj rregullore, ose të tregojë që kandidati ka përmbushur të drejtën e përjashtimit nga kryerja e praktikës profesionale. Vetëm pasi është kryer pagesa e regjistrimit aplikantit i lind e drejta për t'u konsideruar kandidat. Procesi i regjistrimit në provime behet në përputhje me këtë rregullore.
2. Sekretaria teknike e KPAP-së, përpunon të gjitha kërkesat e grumbulluara dhe përgatit listën e të gjithë kandidatëve, shoqëruar me informacion në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga secili kandidat. Sekretaria Teknike duhet të dorëzojë pranë KPAP-së brenda 3 ditëve pune pas përfundimit të afatit zyrtar të aplikimit, një listë përmbledhëse të të gjithë aplikantëve dhe dokumentacionin përkatës të secilit. KPAP-ja si dhe personi përgjegjës për mbikëqyrjen kanë të drejtën që të kërkojnë dosjen së bashku me çdo evidence të grumbulluar për secilin nga kandidatët nëse është e nevojshme ose në rast se ka ankim nga kandidatët përgjatë procesit.
3. Sekretaria Teknike ka për detyrë të pranojë dhe të ruajë të gjitha aplikimet e bëra nga kandidatët për AL dhe kandidatët për KM në përputhje me këtë rregullore si dhe në përputhje me të gjitha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

aktet e miratuara nga BMP-ja. Detyrat e sekretarisë teknike të KPAP-së janë vetëm teknike dhe organizative brenda tagrave të përcaktuara nga kuadri i zbatueshëm rregullator i BMP-së.

4. Të gjitha kërkesat e grumbulluara, së bashku me evidencat origjinale do të jenë subjekt i mbikëqyrjes lidhur me pajtueshmërinë e dokumentacionit të kandidatëve. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen si dhe çdo anëtar i BMP-së në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore mund të jenë prezent në hapjen e kërkesave dhe dosjeve origjinale nga sekretaria teknike.
5. KPAP-ja shpall listën e plotë të kandidatëve për të hyrë në provimet e PPAP-së deri në një muaj, përpara datës së provimit të parë. Procesi i regjistrimit fillon të paktën një muaj përpara shpalljes së listës së aplikantëve. Të gjithë kandidatët për AL dhe KM kanë të drejtën të aplikojnë për t'u regjistruar në secilin provim të parashikuar në geramat a), b) dhe c) të nenit 9 pika 12 të kësaj rregulloreje, pavarësisht rezultatit të provimit paraardhës. Gjithashtu, kandidatët për AL nëse kanë mbyllur me sukses provimet e mësipërme kanë të drejtën të futen në provimet pasardhëse dhe kanë të drejtën të aplikojnë për t'u regjistruar në secilin provim pavarësisht rezultatit të provimit paraardhës.
6. Përpara se të marrin pjesë në testimet e parashikuara në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale (PPAP) kandidatët për AL (me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në ligj dhe në këtë rregullore) duhet të provojnë se kanë kaluar me sukses të gjitha provimet teorike e aftësive profesionale (PTAP) që përfshihen në programin e miratuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, të hartuar sipas kërkesave të pikave 2 e 3 të nenit 18 të ligjit për auditimin.
7. Evidencat e lidhura me pikën 6 të këtij neni duhet të dorëzohen në dosjen e regjistrimit së bashku me dokumentet e tjera në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
8. Për të gjitha ato disiplina, që nuk janë trajtuar nga institucionet përkatëse të arsimit të lartë, organizohen provime të veçanta nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, me të cilat ajo ka nënshkruar marrëveshje.
9. Në rastet kur:
 - a) organizata profesionale e audituesve ligjorë nuk ka nënshkruar një marrëveshje me institucionet e arsimit të lartë apo;
 - b) institucionet e arsimit të lart nuk përgjigjen ndaj kërkesës për bashkëpunim;
 - ç) në raste të ndryshimeve në kurrikulat e institucioneve të arsimit të lartë apo;
 - c) ndryshimeve të konsiderueshme të përmbajtjes së programit të përgatitjes profesionale,organizata profesionale e audituesve ligjorë mund ti organizojë këto teste e vetme me kushtin që procesi i organizimit të testimit të garantojë standarde të njëjta, si dhe vë në dijeni BMP-në për zhvillimin e këtyre testeve.
10. BMP-ja mund të mbikëqyrë procesin e provimeve të parashikuar në pikën 5, 6, 7, 8, dhe 9 të këtij neni duke kontrolluar dosjet e kandidatëve si dhe përmes mundësisë së pjesëmarrjes përmes një përfaqësuesi nga struktura mbështetëse ose personi përgjegjës për mbikëqyrjen, në procesin e kryerjes së testimit si dhe duke shqyrtuar të gjithë procesin e organizimit dhe kryerjes së testimit dhe procesit të vlerësimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

11. Mënyra e mbikëqyrjes së realizimit të provimeve teorike të parashikuara në pikën 6, 8 dhe 9 të këtij neni përcaktohet me vendim të veçantë të BMP.
12. Provimi përfundimtar i aftësive profesionale garanton shkallën e nevojshme të njohurive teorike rreth disiplinave që lidhen me auditimin ligjor dhe aftësinë për të vënë në praktikë njohuri të tilla. Ai realizohet nëpërmjet jo më pak se 4 testeve me shkrim dhe përfshin vlerësimin e aftësive të kandidatëve për auditues ligjorë për të zbatuar në praktikë e për të bërë gjykime profesionale në një shkallë të avancuar në fushat e mëposhtme:
 - a) Raportimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të raportimit financiar;
 - b) zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare;
 - c) zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë;
 - ç) zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit;
 - d) zbatimi i modeleve të duhura të organizimit, drejtimit, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm të njësive ekonomike të biznesit (personave juridikë);dh) përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës.
13. Testimet, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale(PPAP), zhvillohen të paktën një herë në vit në datat e miratuara nga KPAP-ja. BMP me propozim të KPAP përmes një vendimi mund të përcaktojë që testimet në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale për kandidatët për AL ose për kandidatët për KM ose për të dy bashkë të zhvillohen edhe më shumë se një herë në vit, por jo më tepër se tre herë.
14. Kandidatët që kanë fituar titullin “Kontabilist i miratuar”, pasi kanë kaluar testet e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, që parashikohen në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 12 të këtij neni, kalojnë drejtpërdrejt në testet e disiplinave të tjera të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d”, dhe “dh”, të pikës 12, të këtij neni, nëse kanë plotësuar kërkesat e parashikuara në nenet 4 dhe 10 të kësaj rregullore si dhe me kushtin që program i provimeve të dhëna të përcaktuara në pikën 12 të këtij neni nuk kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, për shkak të ndryshimeve thelbësore të legjislacionit, standardeve apo për shkak të ndryshimeve thelbësore të përmbajtjes së tyre të përfshirë në këto nënndarje.
15. Shtetasit shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë kaluar një provim universitar apo ekuivalent, ose kanë një diplomë universitare apo kualifikim ekuivalent në një apo më shumë nga disiplinat e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni, që kandidojnë për AL, mund të përjashtohen nga testimi i aftësive teorike profesionale (PTAP) për disiplinat e mbuluara nga këto provime ose diploma në rast se janë në përputhje me programin e përgatitjes profesionale të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe miratuar nga BMP-ja.



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

16. Për shtetasit e huaj apo audituesit ligjorë të huaj BMP-ja mund të miratojë tarifa të ndryshme nga ato të parashikuara në rregulloren për mbledhjen e të ardhurave lidhur me testimet e PPAP-ve sipas parimeve të reciprocitetit.
17. Të gjithë AL që janë certifikuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit 47/2016 dhe që plotësojnë kërkesat e pikës 19 dhe 20 të këtij neni kanë të drejtën të njehsojnë/ekuivalentojnë kurrikulat me programet e reja. Njehsimi propozohet nga KPAP-ja dhe miratohet nga BMP-ja me kërkesë të çdo të interesuari i cili zotëron titullin e Ekspertit Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjor) pavarësisht nëse është pjesë e regjistrit publik ose jo. Një kopje e vendimit i çohet KPAP-së dhe organizatës profesionale të audituesve ligjorë për të bërë njehsimin.
18. Njehsimi i kurrikulave behet vetëm për qëllime profesionale brenda apo jashtë vendit të të interesuarve, por në asnjë rast pa prekur të drejtën e ushtrimit të profesionit apo të drejtat dhe detyrimet që lindin prej ligjit. Pas njehsimit AL do të pajiset me formatin e ri të Certifikatës dhe Licencës si dhe me një program lëndësh të zbërthyer sipas programit të ri.
19. Të gjithë Ekspertet Kontabël të Regjistruar (Audituesit Ligjorë) që kanë fituar titullin përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj organizatës profesionale përkatëse si dhe BMP-së, iu lind e drejta e njehsimit në mënyrë të menjëhershme.
20. Për njehsimin e kurrikulave paguajnë një tarifë, e përcaktuar me vendim të BMP dhe derdhet në llogaritë e BMP-së në përputhje me Rregulloren për Mbledhjen e të Ardhurave. Një kopje e dëshmisë se pagesës dorëzohet bashkë me kërkesën për njehsim.
21. Për KM të cilët duan të bëjnë njehsimin e kurrikulave me programet e reja zbatohen dispozitat e pikave 17, 18, 19, 20 (të zbatueshme në mënyrë analoge vetëm për pjesën e kontabilistit të miratuar) me kushtin që të japin testimin e parashikuar në pikën 12, germa c) të këtij neni. Testimi i parashikuar në pikën 12 germa c) të këtij neni për këta kandidatë mund të organizohet në çdo kohë nga KPAP-ja për të kryer testimin për zhvillim profesional të zbatimit në praktikë të kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë.
22. Tarifat që do të aplikohen për KM përpara hyrjes në fuqi të ligjit 47/2016 për hyrjen në testimin vullnetar/për zhvillim profesional të përcaktuar në pikën 12, germa c e këtij neni do të ndahen në sezonale dhe jo sezonale. Tarifat sezonale nënkuptojnë tarifën që aplikohen për këta kandidatë nëse ata vendosin të hyjnë gjatë periudhës së organizimit të provimeve për kandidatët për KM dhe AL. Tarifat jo sezonale nënkuptojnë tarifën e veçanta kur provimi organizohet jashtë programit vjetor të provimeve për kandidatët për KM dhe AL. Tarifat sezonale për të dhënë testin vullnetar/për zhvillim profesional për “zbatimin në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë” në provimin e Taksimit të Avancuar janë të njëjtat tarifa që janë parashikuar në rregulloren për mbledhjen e të ardhurave të BMP.-së. Tarifat jo sezonale përcaktohen me vendim të veçantë të BMP.. Mënyra e organizimit dhe kushtet për të hyrë në testin vullnetar/për zhvillim profesional për “zbatimin në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë” / provimin e Taksimit të Avancuar kur ka më pak se 5 kandidat bëhet me vendim të veçantë të BMP-së.
23. Njehsimi i kurrikulave për KM bëhet vetëm për qëllime profesionale brenda apo jashtë vendit të të interesuarve si dhe për t'u njohur si program në rast se duan të ndjekin programin për AL por



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

në asnjë rast pa prekur të drejtën e ushtrimit të profesionit si KM apo të drejtat dhe detyrimet që lindin prej ligjit.

KREU IV
KUADRI RREGULLATOR I PËRGJITHSHËM DHE MBIKËQYRJA E PRAKTIKËS
PROFESIONALE

Neni 10

Dispozita të përgjithshme mbi praktikën profesionale dhe hyrjen në profesion

1. Rregullat e detajuara për hyrjen, ndjekjen dhe përjashtimin nga praktika profesionale përgatiten nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohen nga BMP-ja duke respektuar dispozitat e këtij neni dhe rregulloret për edukimin, kualifikimin e vijueshëm, mbikëqyrjen dhe rregullimin e praktikës profesionale të miratuara nga BMP-ja, sipas kërkesave ligjore.
2. Bordi i Mbikëqyrjes Publike pasi merr propozime të sjella nga organizatat profesionale, i shqyrton ato dhe nëse ka rekomandime nga anëtarët i përfshin ato drejtpërdrejtë në rregullat përfundimtare të cilat miratohen nga BMP-ja.
3. Përpara se të testohet në provimin përfundimtar për marrjen e titullit “Auditues Ligjor”, me qëllim që të regjistrohet në regjistrin publik të audituesve ligjorë, kandidati duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 15 të ligjit për auditimin dhe dispozitat zbatuese të parashikuara në rregulloret për edukimin, kualifikimin e vijueshëm, mbikëqyrjen dhe rregullimin e praktikës profesionale. Për përjashtimin nga kryerja e praktikës profesionale zbatohen kërkesat e nenit 15 të ligjit për auditimin dhe dispozitat zbatuese të rregulloreve përkatëse.
4. Individët që përjashtohen nga praktika profesionale duke qenë se kanë 15 vite angazhim në veprimtari profesionale, në përputhje me pikën 6 të nenit 15 të ligjit për auditimin, i nënshtrohen të njëjtut proces testimi, të cilit i nënshtrohen edhe kandidatët.
5. Individët që kërkojnë të përjashtohen nga kryerja e praktikës profesionale duhet t`i dorëzojnë një kërkesë me shkrim këshillit të drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë së bashku me dokumentacionin mbështetës që provon se kandidati plotëson kohën e angazhimit për t`u përjashtuar nga praktika profesionale. Ky dokumentacion është subjekt i mbikëqyrjes. Këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë përcjell pranë BMP, propozimin për përjashtimin ose jo nga kryerja e praktikës profesionale të këtyre individëve, brenda 30 ditëve kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës pranë IEKA. Propozimi për përjashtim duhet të përmbajë dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Relacion shoqërues në të cilin argumentohet propozimi për përjashtimin nga praktika profesionale;
 - b. Kopje të dosjes së dorëzuar nga individi sipas kërkesave të rregullores së edukimit të vijueshëm profesional të IEKA;
 - c. Evidencë për angazhimin prej të paktën 5 (pesë) viteve në fushën e auditimit ligjor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

6. BMP shqyrton dhe miraton propozimin e përcjellë nga organizata profesionale e audituesve ligjorë kur propozimi është në pajtim me ligjin dhe kërkesat e kësaj rregulloreje. BMP-ja ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim propozimin e sjellë pranë tij duke dhënë rekomandimet dhe sugjerimet përkatëse për plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë rregullore për përjashtimin nga praktika profesionale. Këshilli i drejtimit në propozimin e rishikuar duhet të plotësojë të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e BMP. Organizata profesionale e audituesve ligjorë përcjell pranë KPAP një kopje të vendimit të përjashtimit nga praktika profesionale.
7. BMP kërkon përditësim të dokumentacionit të dorëzuar nga individ, në rast se OPAL nuk përcjell propozimin për përjashtim në përputhje me afatet dhe kërkesat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni.
8. Përjashtohen nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale shtetasit shqiptarë, të cilët kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër dhe që janë anëtarë të një organizimi profesional të audituesve ligjorë në një shtet tjetër duke qenë të detyruar të japin vetëm provimet e parashikuara në nenin 9 pika 12 gërma b) dhe c).

KREU V
DOKUMENTACIONI NË MBYLLJE TË PROCESIT TË CERTIFIKIMIT DHE
ANKIMIMI

Neni 11
Dëshmitë e testimit

1. Për çdo testim (provim) të dhënë, lidhur me PPAP-të, kandidati fitues do të pajiset me dëshmi të firmosura nga Kryetari i KPAP-së dhe anëtari më i vjetër i KPAP-së.
2. Në dëshmi tregohen pikët e fituara. Çdo dëshmi përgatitet në dy kopje, nga të cilat një i jepet kandidatit dhe tjetra ruhet në dosjen e kandidatit.
3. Për kandidatët për Auditues Ligjor në përfundim të procesit të testeve, BMP-ja pajis kandidatët të cilët kanë përfunduar plotësisht praktikën profesionale tre vjeçare dhe që i ka fituar të gjitha provimet, me një dokument zyrtar të emërtuar “CERTIFIKATË“, që vërteton përfundimin me sukses të praktikës profesionale dhe të gjithë PPAP-ve për Audituesin Ligjorë.
4. Për kandidatët për Auditues Ligjor në përfundim të procesit të testeve BMP-ja pajis kandidatët të cilët kanë përfunduar pjesërisht praktikën profesionale (në përputhje me nenin 15, pika 1, gërma c) e ligjit për auditimin) dhe që i ka fituar të gjitha provimet, me një dokument zyrtar të emërtuar “DËSHMI PËR MBYLLJEN E PROVIMEVE“, që vërteton mbylljen e provimeve të PPAP-së. Vetëm pasi ka mbyllur plotësisht praktikën profesionale kandidatit i lind e drejta për të marrë certifikatën e cila dëshmon se ka fituar titullin profesional Auditues Ligjor.
5. Për kandidatët për Kontabilist i Miratuar që kanë përmbushur plotësisht dispozitat e ligjit për auditimin si dhe kërkesat e kësaj rregulloreje dhe që i ka fituar të gjitha provimet, BMP-ja pajis



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

kandidatin me një dokument zyrtar të emërtuar “CERTIFIKATË” që vërteton përfundimin me sukses të dhe të gjithë PPAP-të përkatëse, të kërkuara për KM.

6. Formati i dokumenteve të pikës 1, 3, 4 dhe 5 propozohen nga organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe miratohet nga BMP-ja.
7. Dëshmitë e çdo provimi dhe Certifikatat përfundimtare (Kontabilist i Miratuar ose Auditues Ligjor) janë me numër rendor dhe regjistrohen progresivisht në një regjistër të posaçëm të KPAP-së që mbahet nga sekretaria teknike e OPAL, i cili dorëzohet në fund të çdo procesi provimi përfundimtar pranë strukturës mbështetëse e BMP-së.
8. Certifikatat e lëshuara nga KPAP-ja dhe BMP-ja janë të ndryshme nga Licencat Profesionale dhe shërbejnë si dokument zyrtar për t`iu lejuar kandidatëve që kanë fituar titujt përkatës (Auditues Ligjor, Kontabilist i Miratuar) dhe që kanë përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për auditimin dhe kuadri rregullator i miratuar nga BMP-ja të fitojnë të drejtën për ushtrimin e profesionit.
9. Licencat e AL merren pasi kandidatët janë përfshirë në regjistrin Publik të Audituesve Ligjorë.
10. Licencat e KM merren pasi kandidatët që kanë fituar titullin profesional KM janë anëtarësuar në një organizatë profesionale të kontabilistëve të miratuar të njohur nga BMP-ja (në përputhje me dispozitat e nenit 51 të ligjit për auditimin) dhe janë përfshirë në regjistrin e këtyre organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar.

Neni 12

Ruajtja dhe asgjësimi i dokumentacionit lidhur me certifikimin

1. Dokumentet zyrtare që përgatiten lidhur me procesin e certifikimit dorëzohen dhe ruhen në fund të çdo sezoni në arkivën e BMP-së në përputhje me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të fletoreve të provimeve të kandidatëve pjesëmarrës, të cilat ruhen jo më shumë se 12 muaj nga data e dhënies së provimit, në varësi të procesit të ankimimit.
2. Asgjësimi i fletoreve bëhet nga një komision prej 3 (tre) anëtarësh, 1 anëtar i caktuar nga struktura mbështetëse e BMP-së dhe 2 nga sekretaria teknike e KPAP-së. Deri në asgjësimin e tyre, fletoret administrohen nga sekretaria teknike pranë ambienteve të BMP..

Neni 13

Ankimi

1. Kandidatët për të përfituar titullin për Auditues Ligjor ose Kontabilist i Miratuar kanë të drejtën e ankimit pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike në rastet në vijim:
 - Për vendimet e marra nga KPAP-ja;
 - Për propozimet dhe vendimet e marra nga këshilli i drejtimit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë ose organizatës së kontabilistëve të miratuar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- Për refuzimin për pranim të dokumentacionit nga sekretaria teknike e KPAP-së ngritur pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë si dhe nga Struktura Mbështetëse e BMP-së;
 - Për problematika të lidhura me procesin e organizimit të testimeve apo të tjera problematika të lidhura me hartimin dhe përmbajtjen e tezave;
 - Për çdo çështje tjetër lidhur me procesin e testimit, e cila është nën autoritetin e BMP-së.
2. Kandidatët për t'u bërë anëtarë të KPAP-së kanë të drejtën e ankimit pranë Bordit të Mbiqëqyrjes Publike në rastet në vijim:
- Për propozimet dhe vendimet e marra nga institucioni/organizata ku ata aderojnë;
 - Për zvarritjen ose refuzimin e shqyrtimit të dosjes nga institucioni/organizata ku ata aderojnë;
 - Për refuzimin për pranim të dosjes nga Struktura Mbështetëse e BMP-së;
 - Për problematika të lidhura me procesin e organizimit të njoftimit, thirrjes dhe përzgjedhjes së kandidatëve të propozuara apo të tjera problematika të lidhura me mbarëvajtjen e procesit;
 - Për çdo çështje tjetër e cila është nën autoritetin e BMP-së.
3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në këtë rregullore BMP-ja mblidhet me qëllim shqyrtimin e ankimit jo më herët se 10 ditë pune dhe jo më vonë se 45 ditë pune nga momenti i dorëzimit të ankesave pranë Strukturës Mbështetëse.
4. Të gjitha rastet e lidhura me ankimet e parashikuara në këtë nen me kërkesë të BMP mund të kalojnë për një mendim teknik pranë strukturës mbështetëse dhe/ose për një mendim ligjor pranë personelit dhe/ose komisionit që merret me çështjet ligjore. Në këto raste personeli apo anëtarët e strukturave përkatëse përgatisin një raport duke vendosur referencat ligjore dhe rregullatorë lidhur me çështjen e ankimit. Ky raport i dorëzohet anëtarëve të BMP-së të cilët mund ta konsiderojnë përgjatë procesit të vendimmarrjes.
5. Vendimet e BMP-së do të konsiderohen përfundimtare.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Shfuqizohet.
2. Shfuqizohet.
3. Shfuqizohet.
4. Shfuqizohet.
5. Të gjitha aktet e nxjerra nga BMP-ja përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje që bien ndesh me ligjin ose me këtë rregullore shfuqizohen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

6. Të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin e KPAP apo çdo strukture të lidhur me veprimtarinë e procesit të provimeve dhe çështjeve të lidhura me to të cilat nuk janë parashikuar as në rregulloret e tjera do të rregullohen me vendime të veçanta të BMP-së si dhe nga legjislacioni në fuqi.
7. Për të gjitha ato rregullore dhe vendime të përmendura në këtë rregullore, të cilat nuk janë miratuar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zbatohen vetëm dispozitat e tjera të parashikuara në këtë rregullore, si dhe kërkesat e ligjit të auditimit.
 - 7/1. Shfuqizohet.
 - 7/2. Shfuqizohet.
 - 7/3. Afatet e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, do të rregullohen me vendim të veçantë nga BMP-ja.
 - 7/4. Afatet dhe zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje si dhe mënyra e organizimit të provimeve, mjediseve dhe çështjeve të lidhura me procesin e provimeve, në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ngjarjeve të forcës madhore dhe/ose në gjendjen e pandemisë apo pengesave që mund të shkaktohen si rrjedhojë pandemive, sipas përkufizimeve në legjislacionin përkatës, do të rregullohen me vendim të veçantë të BMP-së duke respektuar kërkesat e këtyre dispozitave.
 - 7/5. Shfuqizohet.
 - 7/6. Mandati i anëtarëve të KPAP, që bie ndesh me dispozitat e kësaj rregullore përfundon automatikisht me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore ose në momentin e konstatimit nga SM, apo institucionet propozuese të anëtarit përkatës.
8. Të gjithë kandidatët që janë regjistruar për të fituar titullin AL por kanë kaluar me sukses së paku të njëjtat provime që kryejnë kandidatët për KM u lind e drejta të marrin edhe titullin e KM. Tarifa për mbulimin e kostove administrative dhe të printimit mbulohet nga personi që aplikon për njohjen e provimeve.
9. Shfuqizohet.
10. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Bordi i Mbikëqyrjes Publike, Komisioni i Provimit të Aftësive Profesionale, Komisioni i Rishikimit, organizatat profesionale që janë subjekt mbikëqyrje së BMP-së, struktura mbështetëse e BMP-së, kandidatët për AL dhe KM, si dhe sekretaria teknike e KPAP-së.